

VENDIM
Nr.170, datë 18.3.2005

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE
TË ENTIT TË TURIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet “Drejtör”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në Entin e Turizmit, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes 1-diplomë e shkollës së lartë – është 9 306 (nëntë mijë e treqind e gjashtë) lekë.
 3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
 4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.
 5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.
 6. Pagat e punonjësve të tjerë të jenë sipas lidhjes II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrave dhe të institucioneve të tjera qendrore”, të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.
 7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
 8. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

EMËRTIMI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG))	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Drejtör i Përgjithshëm	II-a	9 306	2%	0	93 060
Drejtör	II-b	9 306	2%	0	76 516
Përgjegjës sektori	III-b	9 306	2%	0	41 360
Specialist	IV-b	9 306	2%	0	20 680